



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN E
MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:

KUALIFIKIMI PROFESIONAL

“SHËRBIME KUJDESI PËR TË MOSHUAR”
(PILOT- GIZ)

(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)

Tiranë, 2024

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve për Kualifikimin Profesional “**Shërbime kujdesi për të moshuar**”, me strukturë bllok 4 vjeçar, për provimin e detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testimeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- Programet e lëndëve teorike profesionale të Kualifikimit Profesional “**Shërbime kujdesi për të moshuar**”, Niveli IV i KSHK-së (klasa e 10-të, klasa e 11-të, klasa e 12-të dhe klasa e 13-të)
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MFE nr. 27, datë 12.12.2023 “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe Maturës Shtetërore Profesionale 2024”.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**”, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Qëllimi i provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale është vlerësimi i të nxënësve dhe arritjeve si dhe përzgjedhjen e nxënësve për arsimim të mëtejshëm.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar të “**Teorisë profesionale të integruar**” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për Kualifikimin Profesional “**Shërbime kujdesi për të moshuar**”, do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira lëndët të cilat përbëjnë bazën kryesore dhe thelbësore për formimin profesional të nxënësve.. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo lëndë. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Ky program përmban rreth **30 %** të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve të kulturës profesionale. Në këtë program janë përfshirë ato lëndë, të cilat përbëjnë bazën kryesore dhe thelbësore për formimin profesional të nxënësve.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**” në kuadrin e provimit të detyruar “**Teori profesionale e integruar**”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për Kualifikimin Profesional “**Shërbime kujdesi për të moshuar**”, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtme:

1. Edukimi shëndetësor dhe higjiena kl.10-të dhe kl.11-të;
2. Njohuri mbi barnat mjekësore kl.11-të;
3. Bazat e anatomisë dhe fiziologjisë kl.11-të;
4. Njohuri mbi bazat e geriartrisë kl.12-të;

Tabela 1: Lëndët profesionale të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë si më poshtë, duke konsideruar vëllimin dhe rëndësinë e tyre në formimin profesional të nxënësve.

Nr	Lëndët	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Edukimi shëndetësor dhe higjiena	91 orë	23
2	Njohuri mbi barnat mjekësore	92 orë	24
3	Bazat e anatomisë dhe fiziologjisë	108 orë	28
4	Njohuri mbi bazat e geriartrisë	93 orë	25
	TOTALI	384 orë	100%

Temat sipas lëndëve janë:

- a) “**Edukimi shëndetësor dhe higjiena**”, kl.10 dhe kl.11: **(91 orë)**
- Hyrje. Shëndeti dhe sëmundjet 6 orë
 - Historiku i përkujdesjes për të moshuar për të moshuar 7 orë
 - Qëllimet e përkujdesjes për të moshuar për të moshuar 7 orë
 - Ekipi i përkujdesjes për të moshuar për të moshuar 8 orë

• Organizimi i përkujdesjes për të moshuare për të moshuar	10 orë
• Përkujdesja dhe masat shëruese	8 orë
• Procesi i përkujdesjes për të moshuare për të moshuar	10 orë
• Përdorimi mjeteve ndihmëse	8 orë
• Bazat e mikrobiologjisë mjekësore	12 orë
• Infeksionet dhe rrugët e transmentimit	9 orë
• Metodatat fizike të dezinfektimit dhe sterilizimit	6 orë
b) “Njohuri mbi barnat mjekësore” kl.11	(92 orë)
• Njohuri të përgjithshme mbi barnat	2 orë
• Kujdesi në përdorimin e barnave	4 orë
• Rrugët e marrjes së barnave	4 orë
• Shpërndarja e barnave në organizëm	4 orë
• Metabolizmi i barnave në organizëm	4 orë
• Eleminimi i barnave	4 orë
• Barnat me efekt në gjarkullimin e gjakut dhe zemër	10 orë
• Barnat me efekt në traktin e frymëmarrjes	8 orë
• Barnat me efekt traktin tretjes	6 orë
• Barnat me efekt tek syri dhe veshi	10 orë
• Barnat me efekt tek sistemi nervor	8 orë
• Barnat për metabolizmin	6 orë
• Barnat për sistemin hormonal	6 orë
• Kimoterapia	4 orë
• Alergjia medikamentoze dhe efektet e padëshiruara	6 orë
• Bimët mjeksore dhe barnat popullore	6 orë
c) “Bazat e anatomisë dhe fiziologjisë” kl. 11	(108 orë)
• Hyrje në fiziologji	2 orë
• Qeliza dhe funksionet saj	4 orë
• Komunikimi ndërqelizor dhe homeostaza	4 orë
• Potencialet membranore	4 orë
• Hemostaza	4 orë
• Sistemi imunitar	4 orë
• Hyrje në anatomi	2 orë
• Lëkura	6 orë
• Muskujt	10 orë
• Sistemi kockor	10 orë
• Artikulacionet	6 orë

• Zemra	6 orë
• Gjaku dhe qarkullimi i tij	6 orë
• Sistemi i frymëmarrjes	6 orë
• Sistemi i tretjes	6 orë
• Sistemi i shisave	6 orë
• Sistemi genital	10 orë
• Sistemi hormonal	6 orë
• Sistemi nervor	6 orë
d) “Njohuri mbi bazat geriartrisë”, kl. 12	(93 orë)
• Njohuri të përgjithshme për geriatrinë	3 orë
• Ruajtja në normë e funksioneve vitale	4 orë
• Aftësia e ushqyerjes dhe e jashtëqitjes	4 orë
• Gjumi dhe pagjumësia. Aftësia komunikuese.	6 orë
• Sëmundjet kardiovaskulare	10 orë
• Sëmundjet e mushkërive dhe rrugëve të frymëmarrjes	10 orë
• Sëmundjet e aparatit muskuloskeletik	6 orë
• Sëmundjet e aparatit të tretjes	6 orë
• Sëmundjet hormonale	7 orë
• Sëmundjet e aparatit urogenital	8 orë
• Sëmundjet infektive	6 orë
• Sëmundjet e lëkurës	6 orë
• Sëmundjet endokrine, Diabetes Mellitus	7 orë
• Rënia e shikimit, sëmundjet e syrit dhe verbimi	4 orë
• Rënia e dëgjimit, sëmundjet e veshit dhe shurdhimi	4 orë
• Fazat e fundit të jetës dhe vdekja	2 orë